



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 451/4 Prot.

Patos më 31.12.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 30.12.2024

I mbajtur sot më datë 30.12.2024 në orën 13:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë :

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltarë:

1. Armand Ahmetaj
2. Klaudio Alisininaj
3. Smerald Hazizaj
4. Elton Seraj
5. Lori Musaj
6. Albiona Lamaj
7. Ertilla Myrtaj
8. Eduart Faslliaj 
9. Vjollca Kasaj
10. Elmira Rama
11. Novrus Toska
12. Artan Velçani

Takimi hapet nga Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj-Kuorumi ligjor i rregullt, gjithsej 12 (dymbëdhjetë) këshilltarë.

Përhëndetje të nderuar koleg, këshilltarë, jemi mbledhur në këtë mbledhje jashtë radhe me kërkesë të kryetarit të bashkisë në lidhje me një rast, sëmundje e rëndë. Kërkesa e Kryetarit të Bashkisë mban nr. 451 prot., datë 27.12.2024.

Mbledhja është bazuar në nenin 53 pika 3 gërma a të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, si dhe të nenit 59 të “Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin të Këshillit Bashkiak.

Armand Ahmetaj- Rendi i ditës:

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 19.12.2024.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 19.12.2024.

4- Shqyrtimi i kërkesës nr. 4473 prot., datë 23.12.2024 për dhënie ndihmë financiare. Ndihmë ekonomike është shënuar këtu por është ndihmë financiare.

Armand Ahmetaj- Kush është dakord me rendin e ditës?

Kundër s'ka, abstenim ska, miratohet me 12 vota pro.

SEKRETARI


Refaela Xeba



Smerol. Horroj
Edmont Follie
Lori Nossaj

KRYETARI

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. ____ Prot.

Patos më ____ .12.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.12.2024 ora 13:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 19.12.2024.

Armand Ahmetaj- Nëse ka ndonjë diskutim, pyetje apo sygjerim për korrigjim procesverbali?

Eduart Faslliaj- Nuk e kemi procesverbalin.

Refaela Xeba – Jua kam hedhur me email

Eduart Faslliaj- Po ka ardhur por unë e abstendoj .

Albiona Lamaj – Është hedhur në emailin ku na është dërguar njoftimi.

1 abstenim, miratohet me shumicë votash.

SEKRETARI
Refaela Xeba

Smerolët Hoxhë
Eduart Faslliaj
Lori MUSAJ

KRYETARI
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA ESHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. ___ Prot.

Patos më, ___ 12.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.12.2024 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 19.12.2024

Armand Ahmetaj – Të lutem Refaela!

Refaela Xeba, Përshëndetje! Në mbledhjen e datës 19.12.2024 janë marrë gjithsej njëmbëdhjetë vendime nga numri 85 deri në 95, të gjitha vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorisë përkatëse për ekzekutim.

Nga këto 11 vendime vetëm vendimi nr. 87 dhe nr. 90 i është përcjell Prefekturës për verifikim dhe akoma nuk na ka ardhur përgjigja.

SEKRETARI

Refaela Xeba

Smerold. Haziraj

Eduart Fosllig

Lori MUSAJ

KRYETARI

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. ___ Prot.

Patos më, ___ 12.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.12.2024 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Armand Ahmetaj – Pika e katërt është qëllimi i kësaj mbledhje . Kemi një rast sëmundje të rëndë të një vajze shumë të re. Të gjithë jemi në dijeni të këtij rasti dhe presim të solidarizohemi me një ndihmë të caktuar. Fjalën ja kaloj Albës meqë është e fushës.

Albiona Lamaj- Duke qënë pjesë e shëndetësisë dhe në profesion një shpjegim të thjeshtë për diagnozën. Diagnoza sipas kërkesës së paraqitur në këshillin bashkiak është neurofibromatozë që do të thotë pacientja është 22 vjeçe, është në gjendje shumë të rëndë shtuar në spital jashtë shtetit për kurim në gjendje kome.

Gradualisht në bazë të mjekimit është zgjuar nga koma por situata vazhdon të jetë po e rëndë dhe për këtë arsye familjarët e saj për arsye sociale kanë kërkuar ndihmë dhe është bërë dhe mediatike përveç bashkisë është bërë dhe mediatike për donatorë të tjera ndihmues sepse situata vazhdon të jetë e rëndë dhe nuk dihet sa do të qëndrojë nëpër spitale, varet si do marri ecuria.

Duke falenderuar bashkinë që paraqet kërkesën për këshillin bashkiak, duke falenderuar dhe çdo këshilltarë bashkiak që menjëherë u bë pjesë që kjo mbledhje të bëhëj në mënyrë të menjëhershme për ti ardhur në ndihmë familjes unë propozoj këshillin që ti japim ndihmën solidarizuese sepse jam e bindur që edhe kjo ndihmë është e pamjaftueshme për familjen por të paktën një pjesë e solidarizimit dhe e ndihmesës që mund të japim familjes dhe asaj vajze 22 vjeçare unë propozoj që të kalojnë për ndihmë një milion lek të reja.

Faleminderit!

Elmira Rama-atëherë edhe unë ftoj që ta miratojmë këtë kërkesë pasi përpos të gjithave atyre që Alba sqaroi duhet të shtoj se vajza ka qënë nxënëse në shkollën Sotir Çapo Zharrës dhe nga informacionet që kam ka qënë kjo sëmundjeje i ka rënë në një moment të ëndrrave të saj të dëshirave të saj të gjatë duke kërkuar informacion të vijuar dhe studimet në universitet edhe problemet sociale të familjes ekzistojnë ashtu sikurse tha Alba ndaj ftoj që ta miratojë pavarësisht se kjo shumë mund të mos jetë mjaftueshëm ne të jemi në rregull me ndërgjegjen tonë.

Faleminderit!

Zv- Kryetarja Ina Sauli- Përpos faktit që më bëhët qejfi që u gjendëm gati për ti ardhur në ndihmë kësaj familje sepse normalisht dhimbja është e përbashkët. Nëse miratohet kjo vlerë kemi dhe ekzekutivin që mund ta cilësoj dhe pjesën që preket nga fondi rezervë. Kështu që për mendimin tim ta hedhim në votim.

Mimoza Shtëmbari drejtores Financës- Për të përballuar këtë ndihmë financiare do ta mbulojmë nga fondi rezervë i pashpërndarë deri në fund të vitit.

Eduart Faslliaj- Sa është fondi rezervë që ka ngelur pa shpërndarë ?

Mimoza Shtëmbari - një milion e katërqind mijë.

Eduart Faslliaj- Kaq është limiti ligjor besoj që mund të ndihmohet familja.

Mimoza Shtëmbari – Këto janë shumë raste të ndjeshme, ndihmat ekonomike dhe financiare janë të kanalizuar në rrugë të tjera po duke qënë së është rasti shumë i ndjeshëm dhe kaq është mundësia buxhetore për ta ndihmuar.

Eduart Faslliaj- meqë jemi në datën 30 dhe janë 14 milion lekë të vjetra nga fondi rezervë dhe nuk kemi për çfarë ti përdorim ato lekë mendimi im është që tja hedhim të gjitha ato lekë tja japim 14 milion lekë të vjetra.

Mimoza Shtëmbari- Ne vërtet kemi si fond të planifikuar por jo kesh, ne nuk e dimë sa do realizojmë por me analizat buxhetore dhe me mundësitë financiare që ne kemi 1 milion mund ti mbulojmë dhe me burime. Ne vërtet planifikojmë burime në plan por në fund fare kur të mbyllet ky vit buxhetor do shikojmë sa do realizojmë dhe ne të ardhurat dhe në qoftë se pritshmëritë kanë diferencë. Ky fond është i planifikuar. Kaq është parë që ne mund ta mbulojmë.

Eduart Faslliaj- Kaq jeni të sigurt që i keni.

Mimoza Shtëmbari -Nga analiza që kemi bërë them se e mbulojmë.

Armand Ahmetaj- Këshilltarja Klarida Semanjaku e pranishme në sallë. 13 këshilltarë pezantë.

Armand Ahmetaj - Atëherë kalojmë në votim për dhënie ndihmë financiare Znj. Rozalinda Hoxhaj.

Kundër s'ka, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARI

Refaela Xeba



Smeralda Hoxhaj
Eduart Faslliaj
Lore Musaj

KRYETARI

Armand Ahmetaj

